



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**ZËDHËNËSI**

Tiranë, më 29 Dhjetor 2012

*Njoftim për Shtyp*

**MBI ZBULIMIN E KONSTATUAR NË PROCESIN E SHQYRTIMIT**  
**ADMINISTRATIV TË ANKESAVE NGA KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Në zbatim të programit të auditimit nr. 747/1, datë 15/6/2012, KLSH ushtroi auditim në Ministrinë e Brendshme me objekt: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare, për periudhën 1/1/2011 deri më 31/8/2012”. Auditimi u krye konformë kërkesave të programit të auditimit, rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit dhe standardeve të auditimit.

Në përfundim të zbatimit të të gjithë procedurave të përcaktuara, u konstatuan shkelje të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, të kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik dhe veçanërisht nga Kryetari i tij. Konkretisht:

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Prokurimeve të Përqendruara (DPZHPP) në Ministrinë e Brendshme me cilësinë Autoriteti Kontraktor, në disa procedura prokurimi ka kualifikuar në përputhje me rregullat e prokurimit disa operatorë ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat e tyre në vlera më të vogla se sa operatorët e tjerë pjesëmarrës. Disa operatorë të tjerë pjesëmarrës në tender të interesuar për të dalë fitues, kanë paraqitur ankim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP) për këto procedura.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të shqyrtimit administrativ të këtyre ankesave të marra nga Ministria e Brendshme dhe sistemi elektronik i prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, rezultoi se, KPP ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sepse ka s`kualifikuar në kundërshtim me rregullat e prokurimit operatorët ekonomik të cilët kanë paraqitur ofertat në vlera më të ulta. Për pasojë, në zbatim të këtyre vendimeve të KPP-së, të cilat sipas pikës 2, neni 19/1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, janë administrativisht përfundimtare; *Autoritetet Kontraktore, Reparti Ushtarak nr. 1030, Poshnjë dhe Reparti Ushtarak 1001, Zall-Herr*, mbi këtë bazë kanë lidhur kontratat me operatorët ankimues (fitues sipas vendimeve të KPP-së), duke i shkaktuar buxhetit të shtetit **dëm ekonomik në vlerën 225.6 milionë lekë, respektivisht, 163.8 milionë lekë në procedurën e prokurimit për “Shërbimin e gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit (Katering) për Repartin Ushtarak 1030, Poshnjë” dhe 61.8 milionë lekë në procedurën e prokurimit për “Shërbimin e gatimit dhe shpërndarjen e ushqimit për Repartin Ushtarak 1001, Zall-Herr”.**

Për sa më sipër, KLSH ka depozituar kallzim penal pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për konsumim të figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, neni 248 të Kodit Penal të RSH për Kryetarin e Komisionit të Prokurimit Publik, z. E. S. dhe 3 anëtarë të këtij Komisioni,